

Miratohet _____
Ministri i Shëndetësisë
Kryetari i Komisionit të Mbrojtjes nga rrezatimet

AGJENSIA NDËRKOMBËTARE E ENERGJISË ATOMIKE

KODI I DREJTIMIT
PËR SIGURINË DHE SIGURIMIN
E BURIMEVE RADIOAKTIVE

Nr.1388 prot

datë 14.04.2004

PARATHËNIE

Kodi i Drejtimit për Sigurinë dhe Sigurimin e Burimeve Radioaktive u miratua nga Bordi Qeverisës i Agjensisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (ANEA) me 8 shtator 2003. Ai zëvendëson versionin e publikuar (me simbolin IAEA/CODEOC/2001) nga ANEA në mars 2001. Ai pasqyron rezultatet më të rëndësishme të dala nga *Konferenca Ndërkombëtare për Sigurimin e Burimeve Radioaktive* mbajtur në Vjenë në mars 2003 (Konferenca e Hofburgut).

Mbledhja vjetore e G-8, e mbajtur në Evian, Francë, në qershor 2003, lëshoi një deklaratë për „mospërhapjen e armëve të shkatërimit në masë - duke siguruar burimet radioaktive“, në të cilën ajo inkurajonte të gjithë vendet për të forcuar kontrollet për burimet radioaktive dhe përmbushjen e Kodit të Drejtimit¹.

Kodi i Drejtimit shënon kulmin e zhvillimeve dhe përpjekjeve të bëra në vitet e fundit, të cilat janë përshkruar me poshtë.

Konferenca Ndërkombëtare për Sigurinë e Burimeve Radioaktive dhe Sigurimin e Materialeve Radiaktive, mbajtur në Dizhon, Francë, në shtator 1998 evidentoi problemet, nën dritën e të cilave Bordi Qeverisës i ANEA i kërkoi Sekretariatit të ANEA të pregatiste një plan veprimi.

Plani i veprimit, i miratuar nga Bordi Qeverisës në shtator 1999 bëri thirrje për zhvillimin e një Kodi Drejtues për Sigurinë dhe Sigurimin e Burimeve Radioaktive. Në shtator 2000 Bordi Qeverisës u njoftua për Kodin dhe Konferenca e Përgjithshme ftoi vendet anëtare të ANEA të marrin njoftim mbi të dhe të shqyrtojnë masat e nevojshme për zbatimin e tij në shkallë të gjerë .

Mbështetja ndërkombëtare u shpreh shumë shpejt në Konferencën Ndërkombëtare të Autoriteteve Regullatore Kombëtare me Kompetencë për Sigurinë e Burimeve të Rrezatimeve dhe Sigurimin e Materialeve Radiaktive, mbajtur në Buenos Aires në Dhjetor 2000. Në Konferencën e Buenos Airesit iu bë thirrje vendeve anëtare që të sigurojnë zbatimin në praktikë të Kodit².

Në 2001, Sekretariati duke mbajtur parasysh, ndërmjet të tjerash, rezultatet kryesore të Konferencës së Buenos Airesit dhe “Pozicionin e Përbashkët”, nxorri një Plan Veprimi të Rishikuar për Sigurinë dhe Sigurimin e Burimeve të Rrezatimeve (Plani Veprimi i

¹ Mbledhja e G-8 nxorri gjithashtu një plan veprimi, në të cilin ajo shprehte mbështetjen e saj politike për Kodin.

² Mbështetje e mëtejshme për Kodin u shpreh në prill 2001 nga Seminari i Parë Afrikan për Krijimin e Kuadrit Ligjor të Mbrojtjes nga Rrezatimet, Sigurinë e Burimeve të Rrezatimeve dhe Trajtimin e Sigurtë të Mbetjeve Radioaktive. Seminari i mbajtur në Adis Abeba adoptoi një “Pozicion të Përbashkët” në të cilin i bëhej thirrje ANEA të “krijonte një forum për vendet afrikane për të shqyrtuar Kodin e Drejtimit për Sigurinë dhe Sigurimin e Materialeve Radioaktive dhe për ti dhënë atij forcë ligjore, në mënyrë që përdorimi paqësor dhe i sigurtë i teknologjisë bërthamore të mos kompromentohej”.

Rishikuar, miratuar nga Bordi Qeverises më 10 shtator 2001). Plani i Veprimit i Rishikuar i bënte thirrje Sekretariatit për të konsultuar shtetet anëtare lidhur me përvojen e tij në zbatimin e Kodit. Kështu efektiviteti i Kodit u shqyrtua në një mbledhje të ekspertëve ligjor dhe teknik në gusht 2002. Në këtë mbledhje dispozitat e Kodit që lidheshin me sigurimin e burimeve u përforcuan në dritën e ngjarjeve të 11 shtatorit 2001 si dhe u arrit konsensusi për një numër çështjesh të pazgjidhura me parë. U evidentua gjithashtu nevoja e kryerjes së studime të mëtejshme, sidomos lidhur me fushëpamjen e Kodit. Një projekt i Kodit të rishikuar u përgatit për Bordin Qeverisës dhe Konferencën e Përgjithshme në një dokument të ANEA botuar në gusht 2002.

Në mbledhjen e dytë të ekspertëve ligjor dhe teknik, mbajtur në mars 2003, u bënë ndryshime në disa përkufizime në Kod si dhe u shtua inkurajimi gjuhësor për të harmonizuar formatet e regjistrit kombëtar të burimeve radioaktive. Progres u bë gjithashtu në drejtim të përcaktimit të fushëpamjes së Kodit lidhur me futjen e dispozitave që përmirësonin kontrollin e importit-eksportit. Ndonëse nuk u arrit konsensus përfundimtar, ekspertet ranë dakort që teksti final duhet të qarkullohet tek të gjithë shtetet anëtare për koment.

Teksti i Kodit u përgatit për Konferencën e Hofburgut, pas komenteve të bëra nga shtetet anëtare gjatë procesit të qarkullimit të materialit. Në rezultatet e Konferencës të bëra nga Presidenti i saj, u përfshi rekomandimi që vendet të bëjnë përpjekje të përbashkëta për të ndjekur parimet që përmbahen në Kod, të cilat për momentin ishin rishikuar.

Përfundimisht në mbledhjen e tretë të ekspertëve ligjor dhe teknik, mbajtur në korrik 2003, u arrit konsensusi për fushëpamjen e Kodit të rishikuar dhe për tekstin e Kodit të rishikuar.

Më 19 Shtator 2003, në vijim të miratimit të Kodit të rishikuar nga Bordi Qeverisës, Konferenca e Përgjithshme duke mirëpritur vendimin e Bordit, kërkoi që çdo vend t'i shkruante Drejtorit të Përgjithshëm duke deklaruar:

- që ato mbështesin plotësisht dhe përkrahin përpjekjet e ANEA për rritjen e sigurisë dhe të sigurimit të burimeve radioaktive.
- që ato janë duke punuar në drejtim të ndjekjes së udhëzimeve që përmbahen në Kodin e rishikuar.

Për më tepër, ajo i kërkoi Drejtorit të Përgjithshëm, me cilësinë e zotëruesit të burimeve të përdorshme, të hartojë, të mbajë dhe të publikojë një listë të vendeve që angazhohen politikisht me shkrim ndaj tij sikurse kërkohet nga Konferenca e Përgjithshme.

Ndonëse shumica dërrmuese e burimeve radioaktive që përdoren në botë trajtohen në mënyrë të sigurtë dhe i sjellin përfitime mbarë njerëzimit, nuk kanë munguar edhe aksidentet me burime radioaktive, disa me pasoja serioze, bile fatale, dhe në vitet 90 pati një shqetësim në rritje për burimet radioaktive që për një arsye apo një tjetër nuk ishin nën kontroll nga Autoriteti Rregullator ose për të cilit ky kontroll kishte humbur. Sekretariati i ANEA shpreson që zbatimi i këtij Kodi të Drejtimit do të ndihmojë autoritetet kombëtare të krijojnë besimin që burimet radioaktive përdoren brenda një kuadri të përshtatshëm të sigurisë dhe sigurimit të rrezatimeve.

SHTETET ANËTARE TË ANEA

Duke mbajtur parasysh që burimet radioaktive përdoren në gjithë botën me një llojshmëri të gjerë për qëllime përfituese, si p.sh. në industri, mjekësi, kërkime, bujqësi dhe arsim,

Duke qenë të ndërgjegjshëm që përdorimi i këtyre burimeve radioaktive përmban një risk përse i përket ekspozimit potencial të rrezatimit,

Duke njohur nevojat për të mbrojtur individët, shoqërinë dhe mjedisin nga efektet e dëmshme të aksidenteve të mundëshme, të akteve keqbërëse që përfshijnë burime radioaktive,

Duke mbajtur parasysh që një kontrolli rregullator ose menaxhim jo efektiv, jo i vazhdueshëm ose i rrallë ndaj burimeve radioaktive, çon drejt aksidenteve serioze, akteve keqbërëse ose në ekzistencën e burimeve radioaktive të humbura,

Duke qenë të ndërgjegjshëm që risku që vjen nga të tilla incidente duhet të minimizohet dhe të mbrohet nëpërmjet zbatimit të standarteve të përshtatshme për sigurinë dhe sigurimin e rrezatimeve .

Duke njohur rëndësinë e nxitjes së një kulture të sigurisë dhe të sigurimit tek organizatat dhe tek të gjithë individëve të angazhuar në kontrollin rregullator ose menaxhimin e burimeve radioaktive,

Duke njohur nevojat për kontrolle rregullatore efektive dhe të vazhdueshme, në veçanti të zvogëlojë çënimin e burimeve radiaktive gjatë transferimit brenda dhe ndërmjet vendeve,

Duke njohur që vendet duhet të tregojnë kujdesin e nevojshëm në eksportet e autorizuara, veçanërisht sepse një numër vendesh mund të kenë mungesa në infrastrukturën e nevojshme për trajtimin e parrezikshëm dhe mbrojtjen e sigurtë të burimeve radioaktive, dhe që vendet duhet të bëjnë përpjekje për të harmonizuar shtetet e tyre të kontrollit të eksporteve të burimeve radioaktive,

Duke njohur nevojat për pajisje teknike, duke përfshirë mjetet e përshtatshme dhe personel të kualifikuar, të sigurojnë menaxhim të parrezikshëm dhe mbrojtje të sigurtë të burimeve radioaktive,

Duke mbajtur parasysh që Standardet Bazë të Sigurisë për Mbrojtje nga Rrezatimet Jonizuese dhe për Sigurinë e Burimeve të Rrezatimeve përmbajnë rekomandime për mbrojtjen ndaj ekspozimit të rrezatimit jonizues dhe për sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive,

Duke mbajtur parasysh dokumentin e ANEA për Kërkesat e Sigurisë lidhur me Infrastrukturën Qeveritare për Sigurinë Bërthamore, të Rrezatimit, të Mbetjeve Radioaktive dhe të Transportit,

Duke mbajtur parasysh dispozitat e Konventës për Njoftimin e Shpejtee të Aksidentit Bërthamor (1986) dhe dispozitat e Konventës për Ndihmë Rastin e Aksidentit Bërthamor ose të Emergjencës Radiologjike (1986),

Duke mbajtur parasysh dispozitat e Konventës së Përbashkët për Sigurinë e Menaxhimit të Karburantit Bërthamor për Sigurinë e Menaxhimit të Mbetjeve Radioaktive (1997), në veçanti ato dispozita që lidhen me leëizjen ndërkufitare të mbetjeve radioaktive dhe me zotërimin, rifabrikimin dhe groposjen e burimeve të mbyllura të konsumuara,

Duke mbajtur parasysh që edhe kur një material radioaktiv është i përjashtuar nga ky Kod, mund të ketë rrethana në të cilat duhet të menaxhohen në përputhje me objektivat e këtij Kodi,

Duke mbajtur parasysh rolin global të ANEA në fushën e zonën e sigurisë dhe sigurimit të burimeve radioaktive,

Duke mbajtur parasysh kategorizimin e burimeve radioaktive sipas ANEA, që aktualisht gjendet në TECDOC-1344 me titull Kategorizimi i burimeve radioaktive“, por duke mbajtur parasysh që TECDOC-1344 është bazuar në efektet shëndetësore deterministike dhe nuk merr plotësisht parasysh rendin e efekteve që mund të rezultojnë nga aksidente ose aktet keqbërëse që përfshijnë burime radioaktive, dhe

Duke mbajtur parasysh miratimin nga ana e Bordit Qeverisë të aktiviteteve lidhur me mbrojtjen nga terrorizmi bërthamor që i është propozuar atij në mars 2002, duke përfshirë aktivitete që lidhen me sigurimin e materialeve radioaktive, veç materialeve bërthamore,

VENDOSËN që ky Kod i Drejtimit duhet të shërbejë si udhëzues i vendeve anëtare, ndërmjet të tjerash, për zhvillimin dhe harmonizimin e politikave, ligjeve dhe rregulloreve për sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive.

PËRCAKTIME

1. Për qëllimet e këtij Kodi:

“autorizim” nënkupton një leje të dhënë në formë dokumenti nga trupi rregullator për një person fizik ose juridik, i cili ka paraqitur një aplikim për të menaxhuar një burim radioaktiv. Autorizimi mund të jetë në formën e regjistrimit, licenzës ose të masave kontrolluese ligjore efektive, të cilat përmbushin objektivat e Kodit.

“groposje” nënkupton vendosjen e burimeve radioaktive në një objekt të përshtatshëm pa mundësi tërheqje ose lëvizje të tyre.

“burim i konsumuar” nënkupton një burim radioaktiv, i cili nuk mund të përdoret më tej dhe nuk synohet që të përdoret për praktikën për të cilën i është dhënë autorizimi.

“menaxhim” nënkupton aktivitete dhe veprime administrative, që përfshihen në prodhimin, furnizimin, marrjen, zotërimin, ruajtjen, përdorimin, transferimin, importin, eksportin, transportin, mirëmbajtjen, riciklimin ose gruposjen e burimeve radioaktive.

“burim jetim” nënkupton një burim radioaktiv, i cili nuk është nën kontrollin e trupit rregullator si në rastin kur ai nuk ka qënë ndonjëherë nën kontrollin e rregullt ashtu dhe kur ai është braktisur, ka humbur, nuk është vendosur në vendin e duhur, është vjedhur ose është transferuar pa autorizimin e përshtatshëm.

“burim radioaktiv” nënkupton një material radioaktiv që është mbyllur plotësisht në një kapsule ose që është i mbështjellur fort, në trajtë të ngurtë dhe që nuk është përjashtuar nga kontrolli rregullator. Ai nënkupton gjithashtu çdo material radioaktiv që del në rastin kur burimi radioaktiv ka rrjedhje ose është dëmtuar, por nuk nënkupton materiale të kapsuluara për gruposje ose material bërthamor të ciklit të karburantit bërthamore të reaktorëve bërthamor dhe kërkimor.

“trup rregullator” nënkupton një entitet, organizatë ose një sistem entitetesh ose organizatash, të përcaktuara nga qeveria e vendit, që ka autoritetin ligjor për të ushtruar kontrollin rregullator ndaj burimeve radioaktive, duke përfshirë lëshimin e licenzës si dhe rregullimin e një ose më shumë aspekteve për sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive.

“kontroll rregullator” nënkupton çdo formë të kontrollit ose rregullimit, e zbatuar për objektet ose veprimtarinë nga një trupë rregullatore për arsye që lidhen me mbrojtjen nga rrezatimi ose për sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive.

“siguri” nënkupton masat e marra me qëllim zvogëlimin e mundësisë së ndodhjes së aksidenteve që përfshijnë burime radioaktive, dhe duhet që kur një aksident i tillë ndodh, të zbusë pasojat e tij.

“kulturë sigurie” nënkupton bashkësinë e karakteristikave dhe sjelljeve në organizata dhe individë, të cilët vendosin që, duke i dhënë prioritet të theksuar, çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë të tërheqin vëmendjen e kërkuar nga rëndësia e tyre.

“Sigurimi” nënkupton masat për të parandaluar hyrje të paautorizuara, dëmtim, humbje, vjedhje ose transferim të paautorizuar të burimeve radioaktive.

“kulturë sigurimi” nënkupton karakteristikat dhe sjelljen në organizata dhe individë të cilët vendosin që çështjet e sigurimit të tërheqin vëmendjen e kërkuar nga rëndësia e tyre.

“ruajtje” nënkupton mbajtjen e burimeve radioaktive në një objekt që siguron ruajtjen e tyre, por me synimin që ato mund të zhvendosen prej tij.

II. FUSHËPAMJA DHE OBJEKTIVAT

2. Ky Kod zbatohet ndaj të gjitha burimeve radioaktive që mund të zotërojnë një risk të rëndësishëm për individët, shoqërinë dhe mjedisin që janë burimet e referuara në Aneksin I të këtij Kodi . Vendet duhet gjithashtu t'i kushtojnë vëmendje të veçantë rregulloreve për burimet e tjera radioaktive potencialisht të rrezikshme.

3. Ky Kod nuk zbatohet për materialet bërthamore siç përcaktohet në Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore, me përjashtim të burimeve që përmbajnë plutonium-239.

4. Ky Kod nuk zbatohet për burimet radioaktive brenda programeve ushtarake dhe të mbrojtjes.

5. (a) Objektivat e këtij Kodi synojnë që, nëpërmjet zhvillimit, harmonizimit dhe zbatimit të politikave kombëtare, ligjeve dhe rregulloreve dhe nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar:

(i) të arrijnë dhe të mbajnë një nivel të lartë sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive;

(ii) të parandalojnë hyrjet e paautorizuara, dëmtimin, humbjen, vjedhjen ose transferime të paautorizuara të burimeve radioaktive me qëllim zvogëlimin e mundësisë së ndodhjes së ekspozimit të dëmshme të aksidenteve nga këto burime ose përdorimin e burimeve për qëllime keqbërëse për të shkaktuar dëmtime tek individët, shoqëria ose mjedisi; dhe

(iii) të zbusë ose të zvogëlojë pasojat radiologjike të çdo aksidenti ose akti keqbërës që përfshijnë burime radioaktive.

(b) Këto objektiva duhet të arrihen nëpërmjet vendosjes të një sistemi adekuat të kontrollit rregullator të burimeve radioaktive, i zbatueshëm nga faza fillestare e prodhimit deri në fazën e tyre të groposjes dhe të një sistemi për rivendosjen e kontrollit në rastin e humbjes së tij.

6. Ky Kod bazohet në standardet ndërkombëtare ekzistuese që lidhen me sigurinë bërthamore, të rrezatimeve, të mbetjet radioaktive dhe të transportit dhe në kontrollin e burimeve radioaktive. Kodi synon të plotësojë standardet ekzistuese në këto fusha.

III. PARIMET BAZË

TË PËRGJITHSHME

7. Çdo vend duhet, me qëllim mbrojtjen e individëve, shoqërisë dhe mjedisit, të marrë masat e nevojshme për të siguruar:

- (a) që burimet radioaktive brenda territorit të tij ,ose nën juridiksionin ose kontrollin e tij, janë të menaxhuara në mënyrë të parrezikshme dhe të mbrojtura në mënyrë të sigurtë gjatë gjithë jetës së tyre të dobishme; dhe
- (b) nxitjen e kulturës së sigurisë dhe kulturës së sigurimit në drejtim të burimeve radioaktive.

8. Çdo vend duhet të ketë vendosur një sistem kombëtar efektiv legjislativ dhe një sistem rregullator të kontrollit për menaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve radioaktive. Ky sistem duhet:

- (a) të përcaktojë përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e sigurtë dhe sigurimin e burimeve radioaktive ndaj personave të cilëve u është dhënë licenza
- (b) të zvogëlojë mundësinë e humbjes së kontrollit;
- (c) të përfshijë strategjitë kombëtare për fitimin dhe rifitimin e kontrollit ndaj burimeve jetim;
- (d) të sigurojë një përgjigje të shpejtë me qëllim rifitimin e kontrollit mbi burimet jetim;
- (e) forcimin e komunikimit të vazhdueshëm ndërmjet trupit rregullator dhe përdoruesve;
- (f) të sigurojë masat për zvogëlimin e mundësisë së ndodhjes së akteve keqbërëse që përfshijnë sabotimin, në përputhje me kërcënimet e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
- (g) të zbusë ose të zvogëlojë pasojat radiologjike të aksidenteve osë të akteve keqbërëse që përfshijnë burime radioaktive; dhe
- (h) të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të tij.

9. Çdo vend duhet të sigurojë pajisje dhe shërbim të përshtatshëm për mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin, që të përdoren nga persona, që janë të autorizuar për të menaxhuar burime radioaktive. Këto pajisje dhe shërbime duhet të përfshijnë, por pa qënë të kufizuara, nevojat për:

- (a) kërkimet për burimet që mungojnë dhe sigurimin e burimeve të gjetura;
- (b) ndërhyrjen në rast aksidenti ose veprimi keqbërës që përfshin burime radioaktive;
- (c) dozimetrinë personale dhe monitorimin e mjedisit;
- (d) kalibrimin e pajisjeve monituese të rrezatimit.

10. Çdo vend duhet të sigurojë që janë marrë të gjitha masat adekuate për një trajnim të përshtatshëm të personelit të trupit regullator, për agjensitë e zbatimit të legjislacionit dhe organizatat e shërbimit të emergjencës.

11. Çdo vend duhet të krijojë regjistrin kombëtar të burimeve radioaktive. Ky regjistër duhet që minimalisht të përfshijë burimeve radioaktive të Kategorive 1 dhe 2 siç përshkruhen në Shtojcën 1 të këtij Kodi. Informacioni që përmbahet në këtë regjistër duhet të jetë i mbrojtur në mënyrë të përshtatshme. Për të pasur një efikasitet të lartë në shkëmbimin e informacioneve për burimet radioaktive ndërmjet vendeve, ato duhet të marrin masa për harmonizimin e formateve të regjistrave të tyre.

12. Çdo vend duhet të sigurojë informacionin lidhur me çdo humbje të kontrollit mbi burimet radioaktive ose për çdo incident me efekt potencial ndërkuftar, që përfshin burime radioaktive, t'u jepet menjëherë vendeve potencialisht të ndikuara nëpërmjet mekanizmave të ANEA ose mekanizmave të tjera.

13. Çdo vend duhet:

(a) të nxisë rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit në industri, të profesionistëve të shëndetit, të publikut dhe organizatave qeveritare për sigurinë dhe sigurimit e rrezeve që lidhen me burimet jetime; dhe

(b) të përkrahë organizatat dhe personat që mund të ndeshin me burime jetime gjatë punës së tyre (të tillë si përdoruesit e skrapit dhe postet doganore) për të zbatuar programe monitoruese të përshtatshme për detektimin e këtyre burimeve.

14. Çdo vend duhet të përkrahë ripërdorimin ose riciklimin e burimeve radioaktive, kur është praktike dhe në përputhje me konsideratat për sigurinë dhe sigurimin.

15. Çdo vend duhet, në zbatim të këtij Kodi, t'u rikujtojë projektuesve dhe prodhuesve (si prodhuesve të burimeve radioaktive ashtu dhe prodhuesve të pajisjeve në të cilat ndodhen burime radioaktive), furnizuesve, përdoruesve si dhe atyre që menaxhojnë burime të konsumuara, përgjegjësitë e tyre për sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive.

16. Çdo vend duhet të përcaktojë kërcënimet që vijnë nga brenda dhe të vlerësojë vulnerabilitetin (shkallën e dëmtimit) të tij nga këto kërcënimeve për llojet e ndryshme të burimeve që përdoren brenda territorit të tij, bazuar në mundësinë e humbjes së kontrollit dhe të veprimeve keqbërëse që përfshijnë një ose më shumë burime radioaktive.

17. Çdo vend duhet të marrë masa të përshtatshme dhe në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar për të mbrojtur konfidencialitetin e çdo informacioni që merret në mirëbesim bazuar në këtë Kod të Drejtimit, nga një vend tjetër ose nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete që kryhen për zbatimin e këtij Kodi të Drejtimit. Nëse ndonjë vend jep informacion tek organizatat ndërkombëtare në mirëbesim, duhet të merren masa të nevojshme që konfidencialiteti i këtij informacioni të ruhet. Një vend që ka marrë informacion në mirëbesim nga një vend tjetër, duhet t'a japë këtë informacion tek të tretët vetëm me pëlqimin e vendit që ka dhënë informacion. Vendet nuk duhet të japin

informacione që nuk lejohet nga legjislacioni i tyre kombëtar, ose që mund çënojnë sigurinë e këtyre vendeve.

LEGJISLACIONI DHE RREGULLORET.

18. Çdo vend duhet të ketë legjislacionin dhe rregulloret që:

- (a) të përshkruajnë dhe të përcaktojnë përgjegjësitë qeveritare për të realizuar sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive;
- (b) të sigurojnë një kontroll efektiv të burimeve radioaktive;
- (c) të specifikojë kërkesat për mbrojtjen nga ekspozimet e rrezatimit jonizues; dhe
- (d) të specifikojë kërkesat për sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive dhe të pajisjeve, të cilat përmbajnë burime.

19. Legjislacion dhe/ose rregulloret duhet të sigurojnë në veçanti:

- (a) krijimin e një trupi rregullator funksionet rregullatore të të cili janë efektivisht të pavarura nga funksionet e tjera në lidhje me burimet radioaktive, të tilla si menaxhimi i burimeve radioaktive ose nxitja e përdorimit të burimeve radioaktive. Kjo trup duhet të ketë autoritetin dhe karakteristikat e përshkruara në paragrafët 20 deri 22;
- (b) masat për të mbrojtur individët, shoqërinë dhe mjedisin nga efektet dëmtoese të rrezatimit jonizues nga burimet radioaktive;
- (c) kërkesat administrative që lidhen me licencimin e menaxhimit të burimeve radioaktive;
- (d) dispozitat për përjashtim nga kërkesat administrative duke iu referuar paragrafit (c) të mësipërm;
- (e) kërkesat administrative që lidhen me njoftimin e trupit rregullator të veprimeve që përfshijnë menaxhimin e burimeve radioaktive që mund shfaqin një risk të madh tek individët, shoqëria dhe mjedisi;
- (f) kërkesat menaxhuese që lidhen në vecani me krijimin e një politike kontrolli adekuat, e procedurat dhe matjet për kontrollin e burimeve radioaktive;
- (g) kërkesat për masat e sigurimit për të mbajtur, zbuluar ose shtyrë hyrjen, e paautorizuar, vjedhjen, humbjen ose përdorimin e paautorizuar ose zhvendosjen e burimeve radioaktive gjatë të gjithë stadeve të menaxhimit;
- (h) kërkesat që lidhen me verifikimin e sigurisë dhe sigurimit të burimeve radioaktive nëpërmjet vlerësimit të sigurisë dhe sigurimit, monitorimit dhe verifikimit të përputhjes dhe mbajtjes së shënimeve të përshtatshme; dhe
- (i) kapacitetin për të ndërmarre sanksione të përshtatshme.

TRUPI RREGULLATOR

20. Çdo vend duhet të sigurojë që trupi rregullator, i krijuar nga legjislacioni i tij, ka autoritetin për:

- (a) të nxjerrë rregullore dhe për të lëshuar udhëzimet që lidhen me sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive;

(b) t'u kërkojë atyre që pretendojnë të menaxhojnë burime radioaktive që të disponojë një licenzë dhe të paraqesin:

- (i) vlerësimin e sigurisë; dhe
- (ii) planin ose vlerësimin e sigurimit për burimin dhe/ose objektin në të cilën burimi do të menaxhohet, nëse gjykohet e nevojshme nën dritën e riskut që ai zotëron, në rastin e sigurimit edhe vlerësimin e kërcënimit korrent kombëtar;
- (c) të marrë të gjithë informacionin përkatës nga aplikanti për një licenzë;
- (d) të lëshojë, të përmirësojë, të pezullojë ose të revokoje, sipas nevojës, licenzën për menaxhimin e burimeve radioaktive;
- (e) t'i bashkëngjisë licenzës së lëshuar prej tij kushte të qarta dhe të kuptueshme, duke përfshirë kushte që lidhen me:
 - (i) përgjegjësitë;
 - (ii) kompetencat minimale të operatorit;
 - (iii) minimumin e kriterëve për projektim dhe performancë, dhe kërkesat për mirëmbajtje për burimet radioaktive dhe për pajisjet të cilat kanë burime radioaktive;
 - (iv) minimumin e kriterëve të performancës dhe kërkesat për mirëmbajtje për pajisjet dhe sistemet që përdoren për të patur sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive;
 - (v) kërkesat për procedurat e emergjencës dhe linjat e komunikimit;
 - (vi) procedurat e punës që duhet të ndiqen;
 - (vii) menaxhim dhe ruajtje të sigurtë të burimeve të konsumuara, duke përfshirë, kur është e mundur, marrëveshje për kthimin tek prodhuesi të burimeve të konsumuara;
 - (viii) masat për të përcaktuar në mënyrë të përshtatshme, besueshmerinë e individëve të përfshirë në menaxhimin e burimeve radioaktive; dhe
 - (ix) konfidencialitetin e informacionit që lidhet me sigurimin e burimeve.
- (f) të marrë çdo informacion përkatës dhe të nevojshëm nga persona me një licenzë, në veçanti nëse ajo është garantuar nga një vlerësim i rishikuar për sigurinë dhe sigurimin;
- (g) t'u kërkojë furnizuesve dhe transferuesve të burimeve radioaktive ose pajisjeve që përmbajnë burime radioaktive për t'u dhënë marrësve të gjithë informacionin përkatës teknik që të lejojë menaxhimin e tyre në përputhje me masat e sigurisë dhe sigurimit.
- (h) të hyjë në objekte të ndryshme për të ndërmarrë inspektime për të verifikuar përputhshmërinë me kërkesat e trupit rregullator.
- (i) të mbikqyrë zbatimin e kërkesave rregullatore;
- (j) të monitorojë ose të kërkojë nga e organizata të tjera të autorizuar për të monitoruar në pika të përshtatshme me qëllim dedektimin e burimeve jetime;
- (k) të sigurohet për kryerjen e veprimeve korrektuese kur burimi është në kushte jo të sigurtë ose i ruajtur jo mirë;
- (l) të sigurojë, rast pas rasti, dhënien e informacioneve që shihen si të nevojshme, tek personat e licenzuar ose tek publiku, me qëllim mbrojtjen e individëve, publikut dhe mjedisit;
- (m) të lidhet dhe të koordinojë me organe të tjera qeveritare dhe joqeveritare në të gjitha fushat që lidhen me sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive.
- (n) të lidhet me trupa rregullatore të vendeve të tjera dhe me organizata ndërkombëtare duke nxitur bashkëpunim dhe shkëmbim të rregullt informacioni;
- (o) të vendosë kriterë për ndërhyrje në rast situatash emergjence;
- (p) të sigurohet që burimet radioaktive ruhen në objekte të përshtatshme për qëllime ruajtjeje;

(q) të sigurohet që kur burimet e konsumuara ruhen për periudha të gjata kohe, objektet në të cilat ato ruhen janë të përshtatshme për këtë lloj ruajtje;

21. Çdo vend duhet të sigurohet që trupi rregullator:

- (a) përbëhet nga persona të kualifikuar;
- (b) ka burimet financiare, objektet dhe pajisjet e nevojshme për të kryer funksionet e tij në mënyrë efektive; dhe
- (c) është i aftë të tërheqë burime të specializuara dhe ekspertizë nga agjensi të tjera qeveritare.

22. Çdo vend duhet të sigurohet që trupi rregullator:

- (a) të përcaktojë procedurat që lidhen me aplikimin për licenzë;
- (b) të sigurohet për marrjen e të gjitha masave për menaxhim të sigurtë dhe mbrojtje të burimeve radioaktive, duke përfshirë dispozitat financiare në rastin kur burimet kthehen në burime të konsumuara;
- (c) të mbajë shënime të përshtatshme për personat me licenzë për burimet radioaktive me tregues të qartë për llojin e burimeve radioaktive që janë licenzuar për përdorim dhe shënime të përshtatshme për transferimet dhe gruposjen e burimeve radioaktive në fund të afatit të licencës. Këto të dhëna duhet të ruhen në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurtë kundrejt personave që nuk kanë autorizim për t'i parë ato ose personave të tjerë si dhe të mbajë një kopje për të gjithë të dhënat;
- (d) të nxisë krijimin e një kulture sigurie dhe një kulture sigurimi ndërmjet të gjithë individëve dhe organizatave që janë të përfshirë në menaxhimin e burimeve radioaktive;
- (e) të krijojë sisteme për t'u siguruar që si burimet radioaktive ashtu dhe kontejneret e tyre të jenë shënuar nga përdoruesi me shenja të përshtatshme për të paralajmëruar publikun për rrezikun e rrezatimit, dhe kur kjo nuk është e mundur, të paktën kontejneri të jetë me shenjat përkatëse;
- (f) të krijojë sisteme për t'u siguruar që zonat, ku menaxhohen burimet radioaktive janë të shënuara nga përdoruesi me shenja të përshtatshme për të paralajmëruar për punonjësit ose publikun për rrezikun e rrezatimit;
- (g) të krijojë sisteme për t'u siguruar, sa herë që është e mundur, që burimet radioaktive janë të indentifikueshëm dhe të gjurmueshëm, dhe kur kjo nuk është e mundur, të sigurohet për ekzistencën e proceseve alternative për identifikimin dhe gjurmimin e tyre;
- (h) të sigurohet që kontrollet e inventarit kryhen në intervale të rregullta nga persona të autorizuar;
- (i) kryen si inspektime të njoftuara paraprakisht ashtu dhe të befasishme me një shpeshtësi të përshtatshme që mban parasysh performancën e shkuar dhe riskun që paraqesin burimet radioaktive;
- (j) ndërmerr veprime sonduese për të parë përputhjen me kërkesat rregullatore;
- (k) sigurohet që parimet dhe parimet rregullatore janë adekuate dhe të vlefshme, duke marrë parasysh eksperiencën e punës si dhe standartet dhe rekomandimet ndërkombëtare.

(l) kërkon raportime të shpejta nga personat e licenzuar në rastin e humbjes së kontrollit dhe për incidentet që lidhen me burimet radioaktive;

(m) jep udhëzime në nivele të përshtatshme të informimit, instruksione dhe trajnim për sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive dhe për pajisjet dhe objektet në të cilat janë vendosur, tek prodhuesit, furnizuesit dhe përdoruesit e burimeve radioaktive;

(n) u kërkon personave të autorizuar për të përgatitur planet e emergjencës;

(o) është përgatitur ose ka përcaktuar dispozita për të zbuluar dhe vendosur kontrollin e përshtatshëm mbi burimet jetim si dhe të trajtojë emergjencat radiologjike dhe ka përcaktuar plane dhe masa të përshtatshme të reagimit;

(p) është i përgatitur për sa i përket burimeve jetim që e kanë origjinën nga brenda vendit për të ndihmuar në marrjen e informacionit teknik që lidhet me menaxhimin e sigurisë dhe sigurimit të tyre.

IMPORTI DHE EKSPORTI I BURIMEVE RADIOAKTIVE

23. Çdo vend i përfshirë në import-eksportin e burimeve radioaktive duhet të ndërmarrë hapat e përshtatshëm për t'u siguruar që transferimet që janë kryer në përputhje me dispozitat e Kodit dhe që transfertat e burimeve radioaktive të Kategorive 1 dhe 2 të Aneksit 1 të këtij Kodi realizohen vetëm nëpërmjet njoftim paraprak nga vendi eksportues dhe të ketë marrë miratimin e vendit importues në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tij përkatëse.

24. Çdo vend që synon të autorizojë importin e burimeve radioaktive të Kategorive 1 dhe 2 të Aneksit 1 të këtij Kodi duhet të miratojë importimin e tyre vetëm nëse marrësi ka autorizim për marrjen dhe zotërimin e burimit në përputhje me ligjet kombëtare dhe kur vendi ka kapacitetet e përshtatshme teknike dhe administrative, mjetet dhe strukturat rregullatore që nevojiten për t'u siguruar që burimi do të menaxhohet në përputhje të plotë me dispozitat e këtij Kodi.

25. Çdo vend që synon të autorizojë eksportin e burimeve radioaktive të Kategorive 1 dhe 2 të Aneksi 1 të këtij Kodi, duhet të miratojë eksportimin e tyre vetëm nëse është i bindur, me sa të jetë e mundur, që vendi marrës ka persona të licenzuar për të marrë dhe zotëruar burimin dhe ky vend i ka të gjitha kapacitetet e përshtatshme teknike dhe administrative, mjetet dhe strukturat rregullatore që nevojiten për t'u siguruar që burimi do të menaxhohet në përputhje të plotë me dispozitat e këtij Kodi.

26. Nëse kushtet e paragrafëve 24 dhe 25 lidhur me një import ose eksport të veçantë nuk mund të plotësohen, ky import ose eksport mund të autorizohet në kushte të veçanta me pëlqimin e vendit importues, nëse bëhen përgatitje të veçanta është bërë për t'u siguruar që burimi do të menaxhohet në kushtet e sigurisë dhe të sigurimit.

27. Çdo vend duhet të lejoje rifutjen brenda territorit të tij të burimeve të konsumuara, nëse në kuadrin e legjislacionit të tij kombëtar, ai ka pranuar që burimi do të rikthehet te prodhuesi i autorizuar për menaxhimin e burimeve të konsumuara.

28. Çdo vend, i cili autorizon importin ose eksportin e burimeve radioaktive duhet të ndërmarrë hapat e përshtatshëm për t'u siguruar që një import ose eksport i tillë të kryhet në përputhje me standartet përkatëse ndërkombëtare ekzistuese, që lidhen me transportin e materialeve radioaktive.

29. Transporti i burimeve radioaktive përmes teritorit të një vendi ose kalimit tranzit, ndonëse nuk është subjekt i procedurave të licenzimit që përshkruhen në paragrafët e mësipërme 24 dhe 25, duhet të kryhet në përputhje me standartet përkatëse ndërkombëtare ekzistuese që lidhen me transportin e materialeve radioaktive, duke treguar kujdes të vazhdueshëm për mbajtjen e tij nën kontroll gjatë gjithë procesit të transportit ndërkombëtar.

ROLI I ANEA

30. ANEA duhet :

- (a) të vazhdojë mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit për ligjet, rregulloret dhe standartet teknike që lidhen me menaxhimin e sigurtë dhe mbrojtjen e sigurtë të burimeve radioaktive, të zhvillojë dhe vendosë standarde përkatëse teknike dhe të sigurojë zbatimin e këtyre standardeve me kërkesë të ndonjë vendi, ndërmjet të tjerash, duke këshilluar dhe ndihmuar në të gjithë aspektet e menaxhimit të sigurtë dhe të mbrojtjes së sigurtë të burimeve radioaktive;
- (b) të shpërndajë këtë Kod dhe informacionin që lidhet me të; dhe
- (c) të zbatojë në veçanti, masat e miratuara nga organet e saj vendimmarrëse.

SHPËRNDARJA E KODIT

31. Çdo vend duhet, me sa të jetë e mundur, të informojë personat e përfshirë në menaxhimin e burimeve radioaktive si në industri, në shërbimin shëndetsor, në organizatat qeveritare dhe publikun e gjerë, për masat që ai ka marrë në zbatimin e këtij Kodi, si dhe duhet të sigurojë shpërndarjen e këtij informacioni.

ANEKSI I: LISTA E BURIMEVE QË MBULOHEN NGA KODI

Kategoria 1 e burimeve, nëse nuk është menaxhuar në mënyrë të sigurtë ose nuk është mbrojtur në mënyrë të sigurtë, mund të shkaktojë dëmtime të përhershme tek personi që i përdor ose ka qenë në kontakt me to për më shumë se disa minuta. Do të ishte me pasoja vdekjeprurëse qëndrimi afër një sasive materiali të pambrojtur për një periode nga disa minuta deri në një orë. Këto burime përdoren veçanërisht në praktika të tilla si gjeneratorët me burime radioaktive, rrezatuesit e fuqishë dhe burimet e radioterapisë.

Kategoria 2 e burimeve, nëse nuk është menaxhuar në mënyrë të sigurtë ose nuk është mbrojtur në mënyrë të sigurtë, mund të shkaktojë dëmtime të përhershme tek personi, që i mban ose ka qënë në kontakt me to për një kohë të shkurtër (minuta deri në orë) . Do të ishte me pasoja vdekjeprurëse qëndrimi afër një sasie materiali radioaktiv të pambrojtur për një periode nga disa orë deri në disa ditë. Këto burime përdoren veçanërisht në praktika të tilla si radiografia industriale gama, brakiterapia me fuqi doze të lartë dhe me fuqi doze të mesme.

Kategoria 3 e burimeve, nëse nuk është e menaxhuar në mënyrë të sigurtë ose nuk është mbrojtur në mënyrë të sigurtë, mund të shkaktojë dëmtime të përhershme tek personi, që i mban ose ka qënë në kontakt me to për më shumë se disa orë. Do të ishte me pasoja vdekjeprurëse, ndonëse me mundësi të pakta, qëndrimi afër një sasie materiali radioaktiv të pambrojtur për një periode nga disa ditë në disa javë. Këto burime përdoren veçanërisht në praktika të tilla si sondat fikse industriale që kanë burime me aktivitet të lartë (si p.sh.në nivelmatesat, sondat e konvejereve, trashësimatësat) dhe kontrolli i puseve të cpimit.

Tabela I tregon kategorizimin sipas nivelit të aktivitetit për radionuklidet që përdoren më gjerësisht. Ato janë bazuar në vlerën D, e cila përcakton një burim të rrezikshëm d.m.th. një burim, i cili duke qënë jashtë kontrollit mund të japë ekspozime të larta dhe të mjaftueshme për të shkaktuar efekte deterministike. Një listë më e plotë e radionuklideve dhe e niveleve përkatëse të aktivitetëve për çdo kategori si dhe një shpjegim më i plotë përsa i përket vlerës së D mund të gjendet në TECDOC- 1344 , i cili jep metodologjinë e mbështetur, që mund të zbatohet për radionuklide që nuk janë në listë. Përdorimet e burimeve tipike janë treguar më sipër vetëm për qëllime ilustrimi

Përveç këtyre kategorive, vendet duhet ti kushtojnë kujdes të veçantë burimeve radioaktive që konsiderohen nga to se kanë mundësi të shkaktojnë pasoja të papranueshme nëse përdoren për qëllime keqbërëse si dhe grumbullimit të burimeve me aktivitet më të ulët (siç përcaktohet në TEC-DOC 1344), të cilat duhet të menaxhohen në bazë të parimeve të këtij Kodi.

TABELA I. AKTIVITETET QË I KORRESPONDOJNË PRAGJEVE TË KATEGORIVE

Radionuklidi	Kat	1	Kat	2	Kat	3
	1000xD		10xD		D	
	(TBq)	(Ci)a	(TBq)	(Ci)a	(TBq)	(C i)a
Am-241	6.E +01	2E +03	6E -01	2E +01	6E -02	2E +00
Am-241/Be	6E +01	2E +03	6E -01	2E +01	6E -02	2E +00
Cf-252	2E +01	5E +02	2E -01	5E -00	2E -02	5E -01
Cm-244	5E +01	1E +03	5E -01	1E +01	5E -02	1E +00
Co-60	3E +01	8E +02	3E -01	8E +00	3E -02	8E -01
Cs-137	1E +02	3E +03	1E +00	3E +01	1E -01	3E +00
Gd-153	1E+03	3E +04	1E +01	3E +02	1E +00	3E +01
Ir-192	8E+01	2E +03	8E -01	2E +01	8E -02	2E +00

Pm-147	4E +04	1E +06	4E +02	1E +04	4E +01	1E +03
Pu-238	6E +01	2E +03	6E -01	2E +01	6E -02	2E +00
Pu-239 ^b /Be	6E +01	2E +03	6E -01	2E +01	6E -02	2E +00
Ra-226	4E +01	1E +03	4E -01	1E +01	4E -02	1E +00
Se-75	2E +02	5E +03	2E +00	5E +01	2E -01	5E +00
Sr-90(Y-90)	1E +03	3E +04	1E +01	3E +02	1E +00	3E +01
Tm-170	2E +04	5E +05	2E +02	5E +03	2E +01	5E +02
Yb-169	3E +02	8E +03	3E +00	8E +01	3E -01	8E +00
-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----
Au-198*	2E +02	5E +03	2E +00	5E +01	2E -01	5E +00
Cd-109*	2E +04	5E +05	2E +02	5E +03	2E +01	5E +02
Co-57*	7E +02	2E +04	7E +00	2E +02	7E -01	2E +01
Fe-55*	8E +05	2E +07	8E +03	2E +05	8E +02	2E +04
Ge-68*	7E +02	2E +04	7E +00	2E +02	7E -01	2E +01
Ni-63*	6E +04	2E +06	6E +02	2E +04	6E +01	2E +03
Pd-103*	9E +04	2E +06	9E +02	2E +04	9E +01	2E +03
Po-210*	6E +02	2E +03	6E -01	2E +01	6E -02	2E +00
Ru-106*	3E +02	8E +03	3E +00	8E +01	3E -01	8E +00
Tl-204*	2E +04	5E +05	2E +02	5E +03	2E +01	5E +02

* Këto radionuklide kanë shumë pak mundësi për t'u përdorur në një burim radioaktiv individual me nivele aktiviteti që do të mund t'i vendosnin ata në Kategorinë 1, 2 dhe 3 dhe si pasojë nuk do të jenë objekt i paragrafëve që lidhen me regjistrin kombëtar (11) ose të paragrafëve që lidhen me kontrollin e importit dhe eksportit (23 deri 26).

^a Vlerat e para të përdorura janë dhënë në TBq. Vlerat në Kyri janë dhënë për përdorim praktik dhe janë rumbullakosur pas konvertimit.

^b Problemet që lidhen me kritikësinë dhe garancitë duhet të mbahen parasysht për shumëzimin e D.